



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/74 Nr. i faq./Br.str./No.pg 01

Data/Datum/Date 29.09.2025

Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal të datës 13.03.2008, Qarkores Buxhetore 2026/01 e datës 15.05.2025 dhe nenit 10 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika 2.2 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen urgjente e mbajtur më datë 29.9.2025, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e buxhetit për vitin 2026

Neni 1

Komuna e Rahovecit, konform dispozitave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës, miraton buxhetin për vitin 2026 me limitet, në bazë të Qarkores Buxhetore 2026/01 të shpërndara nëpër kategori ekonomike. Buxheti për vitin 2026 është gjithsej 21,547,734.00€, ku grantet qeveritare janë 19,296,320.00€ dhe të hyrat vetanake janë 2,251,414.00€.

Shpërndarja e buxhetit në kategori ekonomike për Komunën e Rahovecit, për vitin 2026, është si vijon:

Paga dhe Mëditje	12,454,555.00 €
Mallra dhe Shërbime	2,761,006.00 €
Shpenzimet Komunale	390,000.00 €
Subvencionet dhe Transferet	1,000,000.00 €
Investimet Kapitale	4,942,173.00 €
Buxheti total për vitin 2026	21,547,734.00 €

Neni 2

Të hyrat buxhetore komunale krijohen nga dy burime: Granti qeveritar dhe të hyrat vetanake, të cilat realizohen nga tarifat dhe ngarkesat e aprovuara në Kuvendin Komunal të Rahovecit.

Neni 3

Shpenzimet nënkuptojnë të gjitha shpenzimet që kryhen nga buxheti komunal dhe buxheti për Arsim dhe Shëndetësi në Komunë, sipas rregullave dhe udhëzimeve financiare të mjeteve të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Neni 4

Ky vendim do të aplikohet së zbatuari nga data 1 janar 2026.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.74/25
Datë:29.09.2025



Arbër Zenuni
Kryesues i Kuvendit